



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 203

Tiranë – E enjte, 19 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 886, datë 13.11.2020	Për një ndryshim në vendimin nr.42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020”, të ndryshuar..... 14421
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 18.11.2020	Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës..... 14422
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 18.11.2020	Për miratimin e paketës së barnave për trajtimin ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID-19, që do të financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor..... 14432



VENDIM

Nr. 886, datë 13.11.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.42, DATË 22.1.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E
SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE
SPITALORE NGA SKEMA E
DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN
2020”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca nr.2, bashkëlidhur vendimit nr.42, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për spitalet, për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR.2
BUXHETI PER SHERBIMIN SPITALOR

SPITALET	Buxheti spitalor 2020 (mijë lekë)						Total
	600	601	602	604	602 laboratorë	rezervë	
Berat	261,100	42,100	170,000	-			473,200
Bulqize	70,300	11,450	30,000	-			111,750
Delvine	32,850	5,245	6,500	-			44,595
Devoll	44,950	7,650	14,000	-			66,600
Diber	230,000	37,790	117,170	-			384,960
Elbasan	394,448	63,480	254,110	-			712,038
Fier	354,259	58,350	266,750	-			679,359
Gramsh	106,500	17,350	42,000	-			165,850
Gjirokaster	192,150	31,570	123,000	-			346,720
Has	44,177	6,680	15,000	-			65,857
Kavaje	101,189	16,600	30,840	-			148,629
Kolonje	76,750	12,270	20,000	-			109,020
Korçe	383,395	60,840	216,000	-			660,235
Kruje	126,073	17,600	26,000	-			169,673
Kuçove	60,700	10,300	15,000	-			86,000
Kukes	239,200	37,350	109,000	-			385,550
Laç	77,000	12,650	30,000	-			119,650
Lezhe	227,612	37,500	128,000	-			393,112
Librazhd	131,350	21,280	54,550	-			207,180
Lushnje	205,371	32,770	104,000	-			342,141
Malesi e Madhe	21,230	3,460	6,000	-			30,690
Mallakaster	39,800	6,570	16,000	-			62,370
Mat	112,600	18,700	36,000	-			167,300
Mirdite	94,618	15,165	27,000	-			136,783
Peqin	33,400	5,425	5,500	-			44,325
Permet	72,500	11,870	35,000	-			119,370
Pogradec	146,676	23,955	77,000	-			247,631
Puke	85,485	13,590	36,000	-			135,075
Sarande	137,300	21,725	105,000	-			264,025
Skrapar	75,430	12,470	17,600	-			105,500



Shkoder	505,955	79,850	219,050	-			804,855
Tepelene	82,750	12,860	16,000	-			111,610
QSUT Tirane	2,321,539	340,950	4,161,870	-	80,000		6,904,359
SUOGJ "Mbretresha Geraldine"	270,000	43,000	285,000	-			598,000
SUOGJ "Koço Gliozheni"	227,000	36,500	185,640	-			449,140
SU "Shefqet Ndroqi"	594,184	53,110	645,000	-			1,292,294
SU Trauma	149,553	19,050	250,000	-			418,603
Tropoje	94,566	15,340	36,000	-			145,906
Vlore	371,815	60,250	323,750	-			755,815
paketat	-	-	-	1,452,880			1,452,880
Spitali Durrës për pandeminë				23,515			23,515
transferat per individe (mjeke specialiste)	-	-	-	20,000			20,000
Pagesa për marrveshjen COVAX				430,000			430,000
rimbursime VKM	-	-	-	15,000			15,000
pagesa e sherb. PPP	-	-	-	2,083,000			2,083,000
rezerve	-	-	-	-		152,049	152,049
TOTAL	8,795,775	1,334,665	8,255,330	4,024,395	80,000	152,049	22,642,214

VENDIM**Nr. 893, datë 18.11.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
DHE TË KRITEREVE PËR
KONTRAKTIMIN E PAGESËN E
AVOKATËVE/STUDIOVE TË
AVOKATISË, EKSPERTËVE APO
SHËRBIMEVE TË TJERA NDIHMËSE
DHE MËNYRA E PAGESËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave dhe i kriterëve për kontraktimin dhe pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë vendase ose të huaja, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse.

2. Procedura për kontraktimin dhe përzgjedhjen e avokatëve/studiove të avokatisë vendase ose të huaja, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse do të kryhet në përputhje me parimin e konkurrencës, të mosdiskriminimit, të transparencës, të trajtimit të barabartë të ofertuesve, duke ruajtur konfidencialitetin e sekretin tregtar të subjekteve.

3. Procedurat e kontraktimit fillojnë kryesisht nga Avokatura e Shtetit ose me kërkesë të personit

juridik të interesuar, të përcaktuar në pikën 1/1, të nenit 5, të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar (këtu e në vijim, personat juridikë), në çështje të rëndësishme për interesat e shtetit ose kur natyra e çështjes kërkon avokatë apo ekspertë të specializuar në fusha të veçanta.

II. KRITERET PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONTRAKTIMIT

1. Avokatura e Shtetit, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike për personat juridikë, në ushtrim të kompetencave për mbrojtjen e interesit pasuror të Republikës së Shqipërisë, vlerëson, rast pas rasti, nevojën e kontraktimit të subjekteve apo të shërbimeve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi.

2. Kur personat juridikë kanë nevojë të asistohen në veprimtarinë e tyre juridike, me kërkesë të motivuar me shkrim, duhet të parashtrinë nevojën për asistencë juridike drejtuar Avokaturës së Shtetit, e cila duhet të përmbajë:

a) argumentimin e fakteve e të rrethanave që kanë çuar në këtë kërkesë;

b) nevojën e natyrën e asistencës juridike të kërkuar;

c) angazhimin e personit juridik për përballimin e të gjitha shpenzimeve ekonomike, të cilat do të rezultojnë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike.

3. Kur Avokatura e Shtetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, konstaton kryesisht se çështja paraqet rëndësi të veçantë për interesat e shtetit ose kur natyra e çështjes kërkon njohuri të specializuara në fusha të veçanta, Avokatura e Shtetit kontraktton subjektet e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të



këtij vendimi, për të ofruar shërbime konsulence ose përfaqësimi në mbrojtje të interesave të shtetit shqiptar.

4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, lidhur me kërkesën e personit juridik të interesuar, të paraqitur sipas pikës 2, të këtij kreu, ose kur konstaton kryesisht sipas pikës 3, të këtij kreu, vendos për fillimin e procedurave të kontraktimit të subjekteve e të shërbimeve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, bazuar në këto kritere:

a) çështja është me rëndësi të veçantë për interesat pasurore të personit juridik apo të Republikës së Shqipërisë;

b) çështja ka një natyrë të veçantë e të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë apo legjislacion të caktuar;

c) çështja ka si objekt dëmshpërblimin për shuma më të mëdha se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;

ç) në raste të tjera të veçanta, të çmuara nga personi juridik ose Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

III. PROCEDURA E KONTRAKTIMIT TË AVOKATËVE/STUDIOVE TË AVOKATISË, VENDASE OSE TË HUAJA, DHE EKSPERTËVE

A. Procedura e konkurrimit

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, pasi vlerëson se plotësohen kriteret e përcaktuara në kreun II, të këtij vendimi, nxjerr urdhër për fillimin e procedurës së konkurrimit, i cili përmban:

a) nevojën për asistencë juridike e kontraktimin e subjekteve dhe shërbimeve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi;

b) objektin e procedurës së kontraktimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

c) komisionin për zhvillimin e procedurës së kontraktimit e të përzgjedhjes së ofertuesit (këtu e në vijim, komisioni).

2. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) avokatë shteti të nivelit qendror, ku, të paktën, njëri prej tyre duhet të jetë nga Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe drejtohet nga njëri prej tyre në cilësinë e kryetarit.

3. Komisioni, brenda 3 (tre) ditëve punë nga data e hyrjes në fuqi të urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, harton ftesën për ofertë dhe ia dërgon atë me shkresë zyrtare ose në mënyrë elektronike subjekteve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, të cilët janë renditur në

udhërrëfyes ndërkombëtarë të njohur, në fushën objekt procedure konkurrimi.

4. Komisioni, në ditën e dërgimit, sipas pikës 3, të këtij seksioni, publikon në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit njoftimin për nevojën e kontraktimit të subjekteve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi. Njoftimi përmban minimalisht objektin e procedurës së kontraktimit, llojin e shërbimit të kërkuar, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm që u jep mundësi subjekteve të interesuara të shprehin interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi. Në vijim të shprehjes së interesit nga subjektet për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi, komisioni i dërgon (me shkrim ose në formë elektronike) subjektit të interesuar ftesën për ofertë.

5. Afati kohor për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 5 (pesë) ditë pune nga dita kur është shpallur njoftimi në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit. Në varësi të natyrës e të llojit të shërbimit, objektit të procedurës së konkurrimit, komisioni mund të caktojë një afat më të gjatë për dorëzimin e ofertave.

6. Ftesa për ofertë përmban:

a) një referencë për njoftimin e publikuar të procedurës së kontraktimit;

b) objektin e procedurës së kontraktimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

c) kriteret për përzgjedhjen e vlerësimit e avokatëve/studiove të avokatisë, vendase ose të huaja, ekspertëve (këtu e në vijim, kriteret);

ç) vendin, datën dhe orën për dorëzimin e hapjen e ofertave;

d) gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumentacionit shoqërues;

dh) informacione të tjera që komisioni i vlerëson të nevojshme.

7. Subjektet e interesuara, brenda 3 (tre) ditëve punë nga dërgimi i ftesës për ofertë/shpallja e njoftimit në faqen e Avokaturës së Shtetit, mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në ftesën për ofertë. Komisioni i jep sqarimet, duke ua dërguar të gjitha subjekteve me shkrim në mënyrë elektronike. Nëse është e nevojshme, për shkaqet e lartpërmendura apo për konstatime të komisionit lidhur me informacionet e përfshira në ftesën për ofertë, komisioni zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertave.

8. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, në adresën e përcaktuar në ftesën për



ofertë, brenda afatit kohor, të përcaktuar si afat i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë nuk shqyrtohet nga komisioni dhe i kthehet e pahapur ofertuesit.

9. Komisioni hap të gjitha ofertat në datën, vendin e kohën e përcaktuar, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar, të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në ftesën për ofertë.

10. Komisioni, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga hapja e ofertave, kualifikon për fazën e mëtejshme të vlerësimit vetëm ato oferta që plotësojnë kriteret për përzgjedhjen e vlerësimit, të përcaktuara në pikën 1, të seksionit B, të këtij kreu. Procesi i përzgjedhjes dhe i vlerësimit vijon nëse pranë Avokaturës së Shtetit është paraqitur të paktën 1 (një) ofertë.

11. Për shqyrtimin e vlerësimit sa më të drejtë të këtyre ofertave, komisioni, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime me shkrim ose në mënyrë elektronike për ofertat e tyre. Në çdo rast, nuk duhet të kërkohej apo të lejohet asnjë ndryshim thelbësor në përmbajtjen e ofertës.

12. Komisioni mund të korrigjojë ato gabime në ofertën/propozimin ekonomik, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Komisioni njofton menjëherë ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim ose në mënyrë elektronike për çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që ofertuesi ta ketë miratuar këtë ndryshim. Nëse ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet.

B. Kriteret për përzgjedhjen e vlerësimit e avokatëve/studiove të avokatisë, vendase ose të huaja, dhe ekspertëve

1. Çdo ofertues, në mënyrë që të kualifikohet për fazën e mëtejshme të vlerësimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- ofertën ekonomike;
- për përvojën profesionale të ofertuesit;
- për eksperiencën të ngjashme të stafit kryesor të propozuar me natyrën e mosmarrëveshjes dhe/ose të shërbimit të kërkuar;
- për raste të suksesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit;
- për besueshmërinë dhe reputacionin;

dh) vërtetim/vetëdeklaratë të licencimit të subjekteve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, për ofrimin e shërbimeve objekt procedure kontraktimi;

e) vërtetim/vetëdeklaratë se subjektet e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, ekzistojnë rregullisht sipas ligjeve në fuqi dhe se nuk ka ndonjë procedurë likuidimi, falimentimi, disiplinore apo tjetër kundër tyre, e cila mund të cenojë ofrimin e shërbimeve;

ë) deklarata se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit.

2. Komisioni vijon me vlerësimin e atyre ofertuesve që kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 1, të këtij seksioni.

3. Komisioni, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga hapja e ofertave, vlerëson ofertat në bazë të sistemit të pikëzimit të përcaktuar, si më poshtë vijon:

Kriteret për përzgjedhjen dhe vlerësimin	Pikët
Oferta ekonomike	25
Përvoja profesionale e ofertuesit	25
Eksperiencën të ngjashme	25
Raste të suksesit	20
Besueshmëria dhe reputacioni	5

4. Komisioni, gjatë procesit të pikëzimit e të renditjes, mban në konsideratë rregullat e përcaktuara, si më poshtë vijon:

a) Oferta ekonomike (monedha dhe vlera) përbën çmimin total e të pandryshueshëm së bashku me vlerën e TVSH-së, nëse është e aplikueshme. Ofertuesit me çmimin më të ulët i jepet vlerësimi maksimal prej 25 (njëzet e pesë) pikësh, ndërsa ofertuesve të tjerë u jepen vlerësime, ku çmimet e tyre janë në përpjesëtim të zhdrejtë me çmimin më të ulët, sipas formulës:

Pikët për propozimin ekonomik = 25 x çmimin më të ulët të ofruar/çmimi ofertues i radhës;

b) Përvoja profesionale e ofertuesit. Për vlerësimin e këtij kriteri, në rastin e përfaqësimit ligjor, do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve, ku ofertuesi është angazhuar përpara forumit përkatës, ku zhvillohet çështja, ndërsa, në rastet e dhënies së konsulencës, do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve, ku ofertuesi ka realizuar



shërbime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit;

c) Ekspierienca të ngjashme të stafit kryesor të propozuar nga ofertuesi, me natyrën e çështjes dhe/ose të shërbimit të kërkuar. Për vlerësimin e këtij kriteri do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve me natyrë të ngjashme me objektin e mosmarrëveshjes dhe/ose shërbimit të kërkuar në të cilat stafi është angazhuar;

ç) Raste të suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit. Për vlerësimin e këtij kriteri, në rastin e përfaqësimit ligjor, do të shërbejë numri i çështjeve të fituara në procedime të ngjashme, ndërsa në rastin e dhënies së konsulencës, do të shërbejë numri i rasteve apo i çështjeve për të cilat ofertuesi ka ofruar konsulencë të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit;

d) Besueshmëria dhe reputacioni. Për vlerësimin e këtij kriteri do të shërbejë besueshmëria dhe reputacioni që gëzon ofertuesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në fushën objekt procedure kontraktimi, e diktuar kjo edhe nga renditja e tij nëpër udhërrëfyes ndërkombëtarë të njohur në fushën objekt procedure kontraktimi.

5. Oferta më e favorshme do të jetë oferta, e cila ka siguruar shumën më të madhe totale të pikëve. Ofertuesi që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve do të renditet i pari dhe, në vijim, ofertuesit e tjerë, sipas pikëve të siguruara.

6. Në rast se ofertuesi paraqitet si bashkim ofertuesish, atëherë oferta duhet të shoqërohet me marrëveshjen e këtij bashkimi ofertuesish, përfshirë të drejtat e përfaqësimit ligjor të tij në procesin e konkurrimit. Secili prej bashkëofertuesve, për t'u kualifikuar në fazën e mëtejshme të vlerësimit, duhet të plotësojë dokumentacionin e përcaktuar në shkronjat “b” – “ë”, të pikës 1, të këtij seksioni.

7. Komisioni mban një procesverbal të hollësishëm për procedurën e ndjekur sipas kreut III, të këtij vendimi, përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

8. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave, komisioni njofton (me shkrim ose në mënyrë elektronike) individualisht secilin ofertues lidhur me vlerësimin e ofertës së tij. Informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin e renditjen e ofertave nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë,

që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

C. Procedura e ankimit

1. Ofertuesit mund të paraqesin ankesë me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Avokaturës së Shtetit, brenda 3 (tre) ditëve punë nga marrja e njoftimit, sikundër përcaktohet në pikën 8, të seksionit B, të këtij kreu.

2. Me marrjen e ankesës me shkrim/elektronikisht nga ofertuesi, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit urdhëron komisionin të pezullojë vazhdimin e procedurës së kontraktimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për ankesën.

3. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me urdhër, ia ngarkon çështjen për shqyrtim një komisioni të përbërë nga 3 (tre) avokatë shteti të nivelit qendror, ku të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Përgjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) avokati shteti të vetëm të nivelit qendror. Anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankesave/avokati i shtetit nuk duhet të ketë/kenë marrë pjesë në komisionin që ka ndjekur procedurën e kontraktimit.

4. Komisioni i shqyrtimit të ankesave/avokati i shtetit, pasi merr informacionin e nevojshëm pranë komisionit të përzgjedhjes, shqyrton ankesën e paraqitur dhe shprehet me vendim me shkrim lidhur me këtë të fundit, brenda 3 (tre) ditëve punë. Ky vendim i njoftohet komisionit të përzgjedhjes dhe ankuesit nëpërmjet Avokatit të Përgjithshëm jo më vonë se dita e nesërme nga marrja e tij.

D. Kontraktimi

1. Komisioni, brenda 2 (dy) ditëve punë nga momenti i përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave dhe të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës për gjithë procesin e kontraktimit dhe ia dërgon për miratim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë:

a) referencën për njoftimin e publikuar të procedurës së konkurrimit;

b) objektin e procedurës së konkurrimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

c) çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës;

ç) korrigjimin e gabimeve aritmetike, nëse ka pasur;



d) ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit;

dh) ofertuesit e kualifikuar dhe mënyrën e vlerësimit të ofertave

e) renditjen e ofertuesve dhe informacion, nëse ka pasur ankesa lidhur me to së bashku me vendimarrjen përkatëse; si dhe

ë) çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me procesin e vlerësimit të ofertave.

2. Me miratimin e raportit përmbledhës nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, brenda 2 (dy) ditëve punë, institucioni i Avokaturës së Shtetit njofton ofertuesin e përzgjedhur fitues dhe e fton atë për nënshkrimin e kontratës.

3. Në kontratën e hartuar nga Avokatura e Shtetit përcaktohen kushtet e ofrimit të shërbimit objekt procesi konkurrimi, ku, ndër të tjera, përfshihet çmimi dhe mënyra e pagesës së subjektit të përzgjedhur fitues, si dhe angazhimi i institucionit të përfaqësuar për të respektuar detyrimet që lindin për të, në lidhje me pagesën. Me lëshimin e faturës nga ana e subjektit fitues, sipas kontratës, Avokatura e Shtetit, pasi konfirmon shërbimin e kryer, ia dërgon faturën personit juridik të interesuar, për të kryer pagesën brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

4. Në rast se ofertuesi i përzgjedhur fitues nuk nënshkruan kontratën, Avokatura e Shtetit fton për lidhjen e kontratës ofertuesin vijues në renditjen e ofertuesve të listuar sipas pikës 5, të seksionit B, të këtij kreu.

5. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit lidh kontratën në emër e për llogari të personit juridik publik që përfaqëson e autorizon një ose më shumë avokatë shteti për ndjekjen e çështjes deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me avokatin/studion e avokatisë, vendase ose të huaj, apo ekspertin e përzgjedhur fitues, si dhe personin juridik përkatës.

6. Avokatura e Shtetit njofton personin juridik përkatës për lidhjen e kontratës dhe i dërgon atij një kopje të saj, në mënyrë që të marrë masat për parashikimet buxhetore. Në të njëjtën kohë, titullari i personit juridik të interesuar autorizon një nëpunës të nivelit të lartë drejtues për ndjekjen e çështjes deri në përfundim të saj, i cili do të ketë kryesisht funksione mbikëqyrjeje, koordinimi dhe komunikimi me Avokaturën e Shtetit e me subjektin e përzgjedhur fitues.

IV. PROCEDURA TË VEÇANTA KONTRAKTIMI

1. Rregullat për procedurat e kontraktimit të specifikuar në krerët II – III, të këtij vendimi, nuk zbatohen për procedurat e veçanta të kontraktimit, objekti dhe qëllimi i të cilave dikton nevojën për zhvillimin e një procedure specifike, të ndryshme nga sa është parashikuar më lart.

2. Procedurat e veçanta zbatohen për rastet, si më poshtë vijon:

a) Kontraktimi i avokatit/studios së avokatisë vendase ose të huaj në rastet e rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi;

b) Kontraktimi i avokatit/studios së avokatisë vendase, në rastet e kundërshtimit dhe/ose fillimit të procedurave për njohjen dhe/ose ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi në juridiksione të huaja;

c) Kontraktimi i ekspertit për nevoja të një procesi arbitrazhi;

ç) Kontraktimi në kushtet e emergjencës.

A. Procedura e kontraktimit të avokatit/studios së avokatisë vendase ose të huaj në rastet e rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi

1. Në rastet e rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi, të inicuar nga njëra nga palët ndërgjyqëse në procedurë arbitrazhi, Avokatura e Shtetit mund të kontraktojë avokatin/studion e avokatisë, vendase apo të huaj, që ka qenë i/e angazhuar me përfaqësimin e shtetit shqiptar apo të personit juridik palë në procesin e arbitrazhit objekt rishikimi/anulimi, vetëm kur plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

a) sipas legjislacionit procedural të aplikueshëm, mund të bëhet ose ka ankim ndaj një vendimi arbitrazhi;

b) sipas rekomandimit të avokatit/studios së avokatisë së angazhuar në procesin e arbitrazhit dhe/ose vlerësimit të Avokaturës së Shtetit, çmohet se ka shkaqe për rishikimin/anulimin e vendimit të arbitrazhit apo realizimin e mbrojtjes kundrejt një ankimi të palës kundërshtare; dhe

c) për shkak të familjaritetit me çështjen dhe/ose afateve të shkurtra për ankimin e vendimit, angazhimi i të njëjtit avokat/studioje avokatie vendase ose të huaj siguron një mbrojtje më efektive të interesave pasurore të të përfaqësuarit, përkatësisht të shtetit shqiptar apo personit juridik respektiv.

2. Në çdo rast, kur avokati/studioja e avokatisë, vendase apo e huaj, i/e angazhuar, në një proces



arbitrazhi, vlerëson paraprakisht se ka shkaqe për fillimin e procesit të rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi, apo për realizimin e mbrojtjes kundrejt një ankimi nga pala kundërshtare, kjo e fundit i paraqet Avokaturës së Shtetit rekomandimin për fillimin e këtij procesi ose pranimin e angazhimit për realizimin e mbrojtjes në rastin e ankimit nga pala kundërshtare. Ky rekomandim do të përmbajë një analizë ligjore për shkaqet që legjitimojnë kundërshtimin e vendimit apo pranimin e realizimit të mbrojtjes ndaj ankimit të palës kundërshtare, e shoqëruar kjo me një ofertë financiare të detajuar për kostot e angazhimit të avokatit/studios së avokatisë në procesin e rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi. Rekomandimi/ pranimi për angazhim i avokatit/studios së avokatisë dhe oferta financiare i përcillet personit juridik të interesuar, të identifikuar si palë, në procesin e arbitrazhit objekt rishikimi/anulimi, me qëllim miratimin ose jo të këtij rekomandimi.

3. Personi juridik i interesuar duhet të shprehet lidhur me rekomandimin për fillimin e procesit të rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi brenda 5 (pesë) ditëve punë nga paraqitja e tij. Në rastin kur personi juridik miraton rekomandimin, duhet t'i konfirmojë Avokaturës së Shtetit parashikimin e fondeve buxhetore në dispozicion për këtë angazhim.

4. Me marrjen e miratimit për fillimin e procesit të rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi nga personi juridik, Avokatura e Shtetit, nënshkruan në emër dhe për llogari të personit juridik një kontratë me të njëjtin avokat/studio avokatie të angazhuar në atë proces arbitrazhi.

5. Vlera e kësaj kontrate do të përbëjë çmimin fiks të ofruar nga avokati/studioja e avokatisë përkatëse, e cila nuk mund të jetë objekt ndryshimi i mëposhëm.

6. Avokatura e Shtetit nuk vijon me këtë procedurë kontraktimi kur:

a) nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1, të këtij seksioni;

b) avokati/studioja e avokatisë, vendase ose e huaj, nuk pranon të angazhohet në procesin e rishikimit/anulimit të vendimit të arbitrazhit; apo

c) vlerëson kryesisht nevojën e kontraktimit për fillimin e procesit të rishikimit/anulimit të vendimit, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 3 e 4, të kreut II.

7. Në rastet e specifikuara më sipër, Avokatura e Shtetit ndjek procedurën e kontraktimit të parashikuar në kreun III, të këtij vendimi ose procedurën e kontraktimit të parashikuar në seksionin D, të kreut IV, të këtij vendimi.

B. Procedura e kontraktimit të avokatit/studios së avokatisë vendase, në rastet e kundërshtimit dhe/ose fillimit të procedurave për njohjen dhe/ose ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi në juridiksione të huaja

1. Kur një person juridik merr njoftimin për fillimin e procedurave për njohjen dhe/ose ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi ndaj tij, në një juridiksion të ndryshëm nga shteti shqiptar, njofton menjëherë Avokaturën e Shtetit.

2. Avokatura e Shtetit, pasi vlerëson rastin, njofton personin juridik, të identifikuar si palë në këtë proces (këtu e në vijim, personi juridik i interesuar), për mundësinë e fillimit të procedurave për kundërshtimin e njohjes dhe/ose të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, duke i paraqitur edhe nevojën e angazhimit të një avokati/studioje avokatie të licencuar vendase për përfaqësimin e mbrojtjen e interesave të personit juridik, në juridiksionin ku ka filluar procesi.

3. Personi juridik i interesuar duhet të shprehet për miratimin ose jo, për fillimin e procedurave për kundërshtimin e njohjes dhe/ose të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit, siç është përcaktuar në pikën 2, të këtij seksioni. Në rastin kur personi juridik i interesuar miraton fillimin e procedurave për kundërshtimin e njohjes dhe/ose ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, ky i fundit duhet t'i konfirmojë Avokaturës së Shtetit mbulimin e kostove për angazhimin e avokatit/studios së avokatisë vendase në këtë procedurë.

4. Me marrjen e miratimit të personit juridik të interesuar, kur paraqiten afate të shkurtra kohore për kundërshtimin e njohjes dhe/ose të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, dhe/ose në rastet kur Avokatura e Shtetit e çmon të arsyeshme, për shkak të familjaritetit me çështjen, kjo e fundit i kërkon avokatit/studios së avokatisë të angazhuar në procesin e arbitrazhit, të paraqesë një ofertë ekonomike për:

a) hartimin e një strategjie mbrojtjeje dhe këshillimi mbi kundërshtimin e njohjes dhe/ose të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit; si dhe



b) për angazhimin e një avokati/studioje avokatie vendase në juridiksionin ku ka filluar procedura për kundërshtimin e njohjes dhe/ose të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, sipas një studimi tregu gjithëpërfshirës e transparent.

5. Avokati/studioja e avokatisë e angazhuar në procesin e arbitrazhit, në përmbushje të shkronjës “b”, të pikës 4, të këtij seksioni, kryen një studim tregu për avokatët/studiot e avokatisë që:

a) ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe janë të licencuar në vendin ku ka filluar procedura e njohjes dhe/ose ekzekutimit të vendimit; si dhe

b) zotërojnë eksperiencën e duhur profesionale në procedime të tilla të ngjashme.

6. Mbi bazën e këtij studimi, avokati/studioja e avokatisë e angazhuar do t'i paraqesë Avokaturës së Shtetit jo më pak se 3 (tre) oferta të avokatëve/studiove të avokatisë që kanë shprehur interesin për t'u angazhuar në përfaqësimin e mbrojtjen e interesave pasurore të shtetit shqiptar ose të personit juridik të interesuar, ndaj të cilit ka filluar procedura e njohjes dhe/ose e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit.

7. Oferta e paraqitur nga avokati/studioja e avokatisë vendase më sipër, përfshin:

a) një curriculum vitae, e cila përmban eksperiencën profesionale për procedime të ngjashme;

b) licencën e avokatit/avokatëve që do të përfaqësojë/në pranë gjykatave të huaja;

c) një analizë për të gjitha hapat/fazat procedurale që do të ndiqen pranë gjykatës së vendit, ku do të kundërshtohet njohja dhe/ose ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit;

ç) ofertën financiare, e cila përmban çmimin për secilën e të gjitha fazat e procesit të paraqitur në mënyrë analitike dhe vlerën tavan për këto shërbime gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

8. Avokati/studioja e avokatisë e angazhuar për procesin e arbitrazhit ia paraqet ofertat Avokaturës së Shtetit. Në këtë rast, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nxjerr urdhër për ngritjen e një komisioni të përbërë nga 3 (tre) avokatë shteti në nivel qendror, ku të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar.

9. Komisioni vlerëson nëse ofertat e paraqitura plotësojnë kërkesat e shkronjave “a”, “b” e “c”, të pikës 7, të këtij seksioni, dhe përzgjedh ofertuesin që ka ofertën financiare më të ulët. Oferta

financiare e përzgjedhur nuk mund të jetë objekt ndryshimi i mëpasshëm.

10. Në përfundim të këtij procesi, Avokatura e Shtetit, në emër dhe për llogari të personit juridik të interesuar, nënshkruan një kontratë sipas qëllimit të përcaktuar në pikën 4, të këtij seksioni, me avokatin/studion e avokatisë së angazhuar për procesin e arbitrazhit, si dhe avokatin/studion e avokatisë vendase të përzgjedhur si ofertuesi fitues.

11. Kur nuk ka avokat/studio avokatie të angazhuar në procesin e arbitrazhit ose kur kjo e fundit nuk pranon të angazhohet, siç është përcaktuar në pikën 4, të këtij seksioni, dhe/ose, kur Avokatura e Shtetit e çmon kryesisht të arsyeshme, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nxjerr urdhër për ngritjen e një komisioni të përbërë nga 3 (tre) avokatë shteti në nivel qendror, ku të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar.

12. Komisioni do të ndjekë procedurën e kontraktimit dhe do të kryejë kryesisht studimin e tregut për avokatët/studiot e avokatisë që:

a) ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe janë të licencuar në vendin ku ka filluar procedura e njohjes dhe/ose e ekzekutimit të vendimit; si dhe

b) zotërojnë eksperiencën e duhur profesionale në procedime të tilla të ngjashme.

13. Në përfundim të këtij studimi, komisioni u dërgon me shkrim ose në mënyrë elektronike ftesën për ofertë avokatëve/studiove të avokatisë të identifikuar e të përzgjedhur në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në pikën 12, të këtij seksioni.

14. Ftesa për ofertë përmban:

a) objektin e procedurës së kontraktimit dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

b) afatet që do të zbatohen për këtë procedurë kontraktimi;

c) vendin, datën dhe orën për dorëzimin e hapjen e ofertave;

ç) informacione të tjera që komisioni i vlerëson të nevojshme.

15. Subjektet e identifikuara dhe të përzgjedhura sipas pikës 12, të këtij seksioni, mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në ftesën për ofertë, sipas afatit kohor të përcaktuar në këtë të fundit. Komisioni i jep sqarimet duke ua dërguar të gjitha subjekteve me shkrim në mënyrë elektronike.



Nëse është e nevojshme, për shkaqet më sipër apo për konstatime të komisionit lidhur me informacionet e përfshira në ftesën për ofertë, komisioni zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertave.

16. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, në adresën e përcaktuar në ftesën për ofertë, brenda afatit kohor, të përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë nuk shqyrtohet nga komisioni dhe i kthehet e pahapur ofertuesit.

17. Komisioni hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar, të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati në përputhje me procedurat e specifikuar në ftesën për ofertë.

18. Për shqyrtimin e vlerësimit sa më të drejtë të këtyre ofertave, komisioni, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime me shkrim ose në mënyrë elektronike për ofertat e tyre. Në çdo rast, nuk duhet të kërkohej apo të lejohet asnjë ndryshim thelbësor në përmbajtjen e ofertës.

19. Komisioni mund të korrigjojë ato gabime në ofertën/propozimin ekonomik, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të propozimeve. Komisioni njofton menjëherë ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim ose në mënyrë elektronike për çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që ofertuesi ta ketë miratuar këtë ndryshim. Nëse ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë propozimi/oferta do të refuzohet.

20. Oferta e paraqitur nga avokati/studioja e avokatisë vendase më sipër, përfshin:

a) një curriculum vitae, e cila përmban eksperiencën profesionale për procedime të ngjashme;

b) licencën e avokatit që do të përfaqësojë pranë gjykatave të huaja;

c) një analizë për të gjithë hapat/fazat procedurale që do të ndiqen pranë gjykatës së vendit, ku do të kundërshtohet njohja dhe/ose ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit;

ç) ofertën financiare, e cila përmban çmimin për secilën dhe të gjitha fazat e procesit, të paraqitur në mënyrë analitike dhe vlerën tavan/maksimale për këto shërbime gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

21. Komisioni, vlerëson ofertat e paraqitura nga avokati/studioja e avokatisë vendase, që kanë shprehur interesin për këtë angazhim. Procesi i përzgjedhjes dhe i vlerësimit vijon nëse pranë Avokaturës së Shtetit është paraqitur të paktën 1 (një) ofertë.

22. Komisioni vlerëson nëse janë përmbushur kërkesat e shkronjave “a”, “b” e “c”, të pikës 20, të këtij seksioni, dhe përzgjedh ofertuesin që ka ofertën financiare më të ulët. Oferta financiare e përzgjedhur nuk mund të jetë objekt ndryshimi i mëpasshëm.

23. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave dhe të përzgjedhjes së ofertuesit, sipas pikës 22, të këtij seksioni, komisioni njofton me shkrim ose në mënyrë elektronike individualisht secilin ofertues lidhur me vlerësimin e ofertës së tij. Informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin e renditjen e ofertave nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të shprehjes së interesit për pjesëmarrje.

24. Komisioni, brenda 2 (dy) ditëve punë nga momenti i përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, përgatit një raport përmbledhës për gjithë procesin e vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë:

a) referencën për njoftimin e publikuar të procedurës së kontraktimit;

b) objektin e procedurës së kontraktimit, si dhe llojin e shërbimit të kërkuar;

c) çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës;

ç) korrigjimin e gabimeve aritmetike, nëse ka pasur;

d) mënyrën e vlerësimit të ofertave;

dh) renditjen e ofertuesve dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me procesin e vlerësimit të ofertave.

25. Me miratimin e raportit përmbledhës nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, brenda 2 (dy) ditëve punë, institucioni i Avokaturës së Shtetit njofton ofertuesin e përzgjedhur fitues dhe lidh një kontratë me këtë të fundit, në emër dhe për llogari të personit juridik të interesuar.

26. Procedura e përcaktuar në këtë seksion zbatohet njësoj edhe në rastin e fillimit të



procedurave për njohjen dhe/ose ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të dhënë në favor të shtetit shqiptar dhe/ose të personit juridik të interesuar.

C. Procedura e kontraktimit të ekspertit për nevoja të një procesi arbitrazhi

1. Kur gjatë procesit të arbitrazhit për konstatimin ose sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e ndryshme për të cilat kërkohet ekspertizë, Avokatura e Shtetit kontraktin ekspert për nevoja të këtij procesi arbitrazhi.

2. Për qëllime të këtij vendimi, “ekspert për nevoja të një procesi arbitrazhi” nënkupton një individ ose person juridik, vendas apo i huaj, që zotëron ekspertizën (aftësi, njohuri dhe eksperiencë) e duhur në fushën e shërbimit, objekt procedure kontraktimi.

3. Kur avokati/studioja e avokatisë e angazhuar në procesin e arbitrazhit rekomandon nevojën e angazhimit të një eksperti, Avokatura e Shtetit, pasi vlerëson rastin, i dërgon personit juridik palë në një proces arbitrazhi, kërkesën e argumentuar për nevojën e angazhimit të ekspertit, dhe kërkon miratimin e personit juridik për angazhimin dhe mbulimin e kostove të ekspertit.

4. Me marrjen e miratimit, Avokatura e Shtetit i kërkon avokatit/studios së avokatisë të angazhuar në procesin e arbitrazhit që të kryejë një studim tregu për ekspertët që zotërojnë eksperiencën e duhur profesionale në fushën, objekt procedure kontraktimi.

5. Mbi bazën e këtij studimi, avokati/studioja e avokatisë e angazhuar në një proces arbitrazhi:

a) i paraqet Avokaturës së Shtetit jo më pak se 3 (tre) oferta të ekspertëve që kanë shprehur interesin për t'u angazhuar në këtë proces. Oferta e paraqitur nga eksperti përfshin eksperiencën profesionale të zotëruar në fushën, objekt procedure kontraktimi dhe vlerën fikse të çmimit të propozuar për shërbimin e ofruar; si dhe

b) i rekomandon Avokaturës së Shtetit ekspertin që vlerëson për t'u angazhuar në këtë proces arbitrazhi, së bashku me argumentet përkatëse.

6. Avokatura e Shtetit përzgjedh, nëpërmjet Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, ekspertin e vlerësuar si më të përshtatshëm për këtë angazhim, dhe ia

komunikon vendimin personit juridik të interesuar, të identifikuar si palë, në këtë proces arbitrazhi.

7. Pas komunikimit të personit juridik përkatës, siç parashikohet në pikën 6, të këtij seksioni, Avokatura e Shtetit lidh në emër dhe për llogari të këtij personi juridik, një kontratë me ekspertin e përzgjedhur dhe me avokatin/studion e avokatisë që përfaqëson çështjen në arbitrazh.

8. Kur personi juridik, palë në një proces arbitrazhi, përfaqësohet nga vetë Avokatura e Shtetit, kjo e fundit identifikon nevojën e angazhimit ose jo të një eksperti. Avokatura e Shtetit i dërgon personit juridik në fjalë, kërkesën e argumentuar për angazhimin e ekspertit, duke i kërkuar njëherazi miratimin për këtë angazhim dhe mbulimin e kostove që rrjedhin nga ky i fundit.

9. Pas marrjes së miratimit, Avokatura e Shtetit, nëpërmjet Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, kryen kryesisht studimin e tregut për ekspertët që zotërojnë eksperiencën e duhur profesionale në fushën objekt procedure kontraktimi dhe u dërgon me shkrim/elektronikisht ftesën për ofertë ekspertëve të identifikuar si më të përshtatshëm për t'u angazhuar në këtë proces arbitrazhi. Ftesa për ofertë do të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë ekspertëve të interesuar, dorëzimin e ofertave të tyre.

10. Avokatura e Shtetit, nëpërmjet Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, vlerëson ofertat e paraqitura nga ekspertët që kanë shprehur interesin për këtë angazhim. Procesi i përzgjedhjes dhe i vlerësimit vijon nëse pranë Avokaturës së Shtetit është paraqitur të paktën 1 (një) ofertë.

11. Oferta e paraqitur nga eksperti përfshin vlerën fikse të çmimit të propozuar për shërbimin e ofruar, si dhe eksperiencën profesionale të zotëruar në fushën, objekt procedure kontraktimi. Në çdo rast, çmimi më i ulët do të përcaktojë ofertën fituese. Çmimi nuk mund të jetë objekt ndryshimi i mëpasshëm.

12. Përzgjedhja e ekspertit të vlerësuar si ofertuesi më i suksesshëm, i njoftohet personit juridik të interesuar, i identifikuar si palë në këtë proces arbitrazhi.

13. Në përfundim të këtij procesi, Avokatura e Shtetit lidh, në emër dhe për llogari të personit



juridik të interesuar, kontratën me ekspertin e përzgjedhur.

D. Procedura e kontraktimit në kushtet e emergjencës

1. Avokatura e Shtetit në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, si dhe kur plotësohen kriteret e përcaktuara në kreun II, të këtij vendimi, mund të vendosë që në kushtet e emergjencës, të zhvillojë një procedurë të përsheptuar për kontraktimin e subjekteve dhe të shërbimeve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi.

2. Rregullat për procedurat e kontraktimit të specifikuar në seksionet A, B e C, të kreut IV, të këtij vendimi, nuk zbatohen për rastet e kontraktimit në kushtet e emergjencës.

3. Kushtet që diktojnë zhvillimin e një procedure të tillë, në rastin e konsulencës, janë afati i shkurtër kohor, më pak se 30 (tridhjetë) ditë, për realizimin dhe sigurimin e mbrojtjes së interesave të shtetit shqiptar dhe/ose të personit juridik.

4. Kushtet që diktojnë zhvillimin e një procedure të tillë, në rastin e përfaqësimit, janë:

a) kushtet e afatet procedurale të shkurtra të përcaktuara sipas forumit të arbitrazhit/legjislacionit të huaj për realizimin e sigurimin e mbrojtjes së interesave të shtetit shqiptar dhe/ose të personit juridik palë në procesin e arbitrazhit/gjyqësor të huaj;

b) marrja dijeni për fillimin e procesit të arbitrazhit/gjyqësor të huaj, në limitet e afatit të përcaktuar sipas forumit të arbitrazhit/legjislacionit të huaj për realizimin e mbrojtjes së interesave të shtetit shqiptar dhe/ose të personit juridik palë në një proces arbitrazhi/gjyqësor të huaj; si dhe

c) çdo rrethanë tjetër e paparashikuar që diktohet sipas forumit/rregullave të arbitrazhit/legjislacionit të huaj, të aplikueshëm për çështjen në fjalë.

5. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ngarkon një komision të përbërë nga 3 (tre) avokatë shteti në nivel qendror, ku të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, që të kryejë kryesisht studimin e tregut mbi subjektet e referuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, të cilët zotërojnë eksperiencën e duhur profesionale në fushën, me objekt mosmarrëveshjeje/konsulencë të përcaktuar në këtë procedurë kontraktimi.

6. Në përfundim të këtij studimi, komisioni u dërgon (me shkrim ose në mënyrë elektronike) ftesën për ofertë subjekteve të identifikuar dhe të përzgjedhura, sipas pikës 5, të këtij seksioni, në fushën objekt procedure kontraktimi, referuar rastit konkret të paraqitur për asistencë juridike, për t'u angazhuar në konsulencë/përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave pasurore të shtetit shqiptar ose të personit juridik të interesuar.

7. Ftesa për ofertë përmban:

a) objektin e procedurës së kontraktimit e llojin e shërbimit të kërkuar;

b) afatet që do të zbatohen për këtë procedurë kontraktimi;

c) vendin, datën, dhe orën për dorëzimin e hapjen e ofertave;

ç) informacione të tjera që komisioni i vlerëson të nevojshme.

8. Subjektet e interesuara mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në ftesën për ofertë, sipas afatit kohor të përcaktuar në këtë të fundit. Komisioni i jep sqarimet duke ua dërguar të gjitha subjekteve me shkrim në mënyrë elektronike.

9. Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, në adresën e përcaktuar në ftesën për ofertë, brenda afatit kohor, të përcaktuar si afati i fundit për dorëzimin e tyre. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë nuk shqyrtohet nga komisioni dhe i kthehet e pahapur ofertuesit.

10. Komisioni hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave në përputhje me procedurat e specifikuar në ftesën për ofertë.

11. Për shqyrtimin e vlerësimin sa më të drejtë të këtyre ofertave, komisioni, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime me shkrim ose në mënyrë elektronike për ofertat e tyre. Në çdo rast nuk duhet të kërkohet apo të lejohet asnjë ndryshim thelbësor në përmbajtjen e ofertës.

12. Komisioni mund të korrigjojë ato gabime në ofertën/propozimin ekonomik, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Komisioni njofton menjëherë ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim ose në mënyrë elektronike për çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që ofertuesi ta ketë miratuar këtë ndryshim. Nëse ofertuesi refuzon të



pranojë korrëgjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet.

13. Komisioni vlerëson ofertat e paraqitura nga subjektet që kanë shprehur interesin për këtë angazhim. Procesi i përzgjedhjes dhe i vlerësimit vijon nëse pranë Avokaturës së Shtetit është paraqitur të paktën 1 (një) ofertë.

14. Kriteret për përzgjedhjen e vlerësimit të ofertuesve, si dhe sistemi i pikëzimit, të përcaktuara në seksionin B, të kreut III, të këtij vendimi, do të aplikohen edhe në këtë procedurë kontraktimi.

15. Komisioni përzgjedh ofertuesin fitues, sipas kriterëve për përzgjedhjen e vlerësimit, si dhe sistemit të pikëzimit të referuar në pikën 14, të këtij seksioni.

16. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave dhe të përzgjedhjes së ofertuesit, sipas pikës 15, të këtij seksioni, komisioni njofton me shkrim ose në mënyrë elektronike individualisht secilin ofertues lidhur me vlerësimin e ofertës së tij. Informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin e renditjen e ofertave nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurohet ruajtja e integritetit të të dhënave, konfidencialiteti i ofertave dhe i shprehjes së interesit për pjesëmarrje.

17. Komisioni, brenda 2 (dy) ditëve pune nga momenti i përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, përgatit një raport përmbledhës për të gjithë procesin e vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Raporti përmbledhës përmban:

- a) referencën për njoftimin e publikuar të procedurës së kontraktimit;
- b) objektin e procedurës së kontraktimit dhe llojin e shërbimit të kërkuar;
- c) çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës;
- ç) korrëgjimin e gabimeve aritmetike, nëse ka pasur;
- d) mënyrën e vlerësimit të ofertave;
- dh) renditjen e ofertuesve dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me procesin e vlerësimit të ofertave.

18. Me miratimin e raportit përmbledhës nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, brenda 2 (dy) ditëve pune, institucioni i Avokaturës së Shtetit njofton menjëherë ofertuesin e përzgjedhur fitues dhe lidh një kontratë me këtë të fundit, në emër dhe për llogari të personit juridik të interesuar. Në

rast se ofertuesi i përzgjedhur fitues nuk nënshkruan kontratën, Avokatura e Shtetit fton për lidhjen e kontratës ofertuesin vijues sipas renditjes së kryer.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr.381, datë 12.6.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyra të avokatisë vendase ose të huaja”, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 908, datë 18.11.2020

PËR MIRATIMIN E PAKETËS SË BARNAVE PËR TRAJTIMIN AMBULATOR NË BANESË TË PERSONAVE TË DIAGNOSTIKUAR ME COVID-19, QË DO TË FINANCOHET NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rimbursimin e paketës së barnave për trajtimin ambulator në banesë për personat e diagnostikuar me COVID-19 nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Paketa e barnave për trajtimin ambulator në banesë të pacientëve të diagnostikuar me COVID-19 përbëhet nga dy skema trajtimi, në përputhje me formën e sëmundjes, sipas udhëzuesit të miratuar nga Komiteti Teknik i Ekspertëve.

3. Vlera e rimbursimit të paketës së barnave për skemën 1 të trajtimit (forma e lehtë) do të jetë jo



më shumë se 1 650 (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Vlera e rimbursimit të paketës së barnave për skemën 2 të trajtimit (forma e mesme) do të jetë jo më shumë se 10 900 (dhjetë mijë e nëntëqind) lekë.

5. Mjeku i familjes, për personat e testuar pozitiv për Sars-Cov-2 (të konfirmuar nga institucionet shëndetësore publike përgjegjëse), në përputhje me formën e sëmundjes dhe indikacionet e përcaktuara në udhëzuesin e miratuar nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, lëshon recetën me rimbursim, sipas rregullave të përcaktuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

6. Për diagnozën COVID-19, e gjithë popullata konsiderohet përfituese nga skema e sigurimeve

shëndetësore, duke u regjistruar dhe identifikuar si e siguruar.

7. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë